



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ / ____ / 2026

I nderuar!

Në vijim të kërkesës suaj protokolluar pranë Bashkisë Shkodër me Nr. 8994 Prot., Datë 16.04.2026, dhe administruar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve dhe Punëve Publike me Nr. 913 Prot, datë 22.04.2026 mbi dhënien e informacionit lidhur me menaxhimin e mbetjeve elektrike dhe elektronike, ju informojmë si më poshtë.

Në territorin e Bashkisë Shkodër realizohet vetëm menaxhimi i mbetjeve të ngurta urbane. Kështu, Bashkia Shkodër nuk bashkëpunon me asnjë operator publik apo privat për menaxhimin e mbetjeve elektrike.

Bashkia Shkodër ka kontratë të lidhur me landfill-in e Bushatit, ku depoziton mbetjet e ngurta urbane të padiferencuara. Duke qenë se në Bashkinë Shkodër nuk bëhet ndarja në burim dhe grumbullimi i diferencuar i mbetjeve, nuk posedojmë të dhëna faktike lidhur me sasinë vjetore të grumbullimit dhe trajtimit të MEE.

Sa më sipër, përgjigja e pyetjes së fundit lidhur me zbatimin e parimit të përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit, më specifikisht për mbetjet elektrike dhe elektronike, akoma dhe sot nuk kemi asnjë operator ekonomik në Bashkinë Shkodër të identifikuar nga ana jonë, i cili ka ngritur një skemë për rekuperimin apo trajtimin e këtyre mbetjeve.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,